



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Publikim Teknik – TP 07

Certifikata e Operatorit Ajror (COA) – Certifikimi i Parë

Material udhëzues (MU)

Parathënie

Hyrje

Materialet Udhëzuese (MU) kanë për qëllim t'i ndihmojnë organizatës/operatorit lidhur me çështjet administrative. Kërkesat dhe proceset administrative do të lehtësojnë lidhjen me Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës (AAC). Ato duhet të konsiderohen si një mjet për organizatën/operatorin në mënyrë që të lehtësohet procesi i marrjes së miratimeve dhe autorizimeve të kërkuara dhe të përcaktuara që jepen nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës (AAC). Përdorimi i MU-së do të ndihmojë arritjen e pajtueshmërisë me kërkesat e AAC-së dhe do të udhëheqë përmes procesit përkatës të certifikimit ose ndryshimit në lidhje me detyrat administrative.

1. Qëllimi

Ky Material Udhëzues (MU) përshkruan procesin e aplikimit dhe marrjes së Certifikatës së Operatorit Ajror (COA) për të kryer operime të transportit ajror komercial sipas Rregullores së AAC-së nr. 01/2019. Prosesi i certifikimit mund të duket një punë e ndërlikuar, veçanërisht për operatorët që certifikohen për herë të parë. Ky MU jep informatat bazë të zbatueshme për procesin e certifikimit.

Ka metoda të ndryshme të pranueshme me qëllim të krijimit të Manualëve të Operimeve. Ky Material Udhëzues (MU) nuk merret me këto metoda të mundshme, por do t'i ndihmojë aplikuesit në përfundimin e “procesit të certifikimit në pesë faza” me vonesa dhe komplikime minimale. Informatat shtesë gjenden në dokumentacionin përkatës siç referohet në paragrafët 2 dhe 3 më poshtë.

2. Rregulloret relevante

Shtojca 3 jep listën e ligjeve dhe rregulloreve relevante të zbatueshme për procesin e certifikimit të parë COA.

3. Materialet dhe dokumentet relevante

Për fusha të caktuara (p.sh. disa nën-kapituj të Manualeve të Operimeve) Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës (AAC) publikon materiale udhëzuese shtesë ose kapituj shembuj (mostër). Këto dokumente ofrojnë më shumë informata lidhur me lëndët specifike.

Përveç kësaj, AAC-ja publikon Udhëzime Administrative (UA) për fusha të veçanta të rregulloreve të botuara me qëllim që të qartësojë ose përkufizojë më hollësisht çështjet relevante sipas nevojës.

4. Sfondi

Pavarësisht neneve 7 dhe 8 të Marrëveshjes për HPEA në lidhje me nenet 4 (1) (a) (ii) dhe 4 (3) të

Protokollit IX të Marrëveshjes ECAA, çdo shtetas i Republikës së Kosovës (siç përcaktohet në Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil) i cili dëshiron të angazhohet në veprimtari (operime) ajrore në Kosovë duhet të marr dhe të posedoj një Certifikatë të Operatorit Ajror (“COA”) aktuale dhe të vlefshme, të lëshuar nga AAC-ja. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës i cili posedon një COA të lëshuar nga AAC dhe i cili dëshiron të angazhohet në transportimin ajror të personave, bagazhit, ngarkesës dhe/ose postës në këmbim me kompensim, qira ose shpërblim, duhet të marrë dhe të ketë në posedim një Licencë për Ushtrimin e Veprimtarisë së Transportit Ajror aktuale dhe të vlefshme, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit e Republikës së Kosovës (MIT) në përputhje me Rregulloren e MIT Nr. 2010/1. AAC-ja e njeh përgjegjësinë e Operatorëve Komercialë të Transportit Ajror për të ofruar shërbimin e transportit ajror të operatorit ajror me shkallën më të lartë të mundshme të sigurisë në interes të publikut. Procesi i certifikimit është hartuar për të siguruar që bartësit e ardhshëm të COA-së ta kuptojnë dhe të jenë në gjendje ta përmbushin këtë detyrë. Kur të përfundojë në mënyrë të kënaqshme, procesi i certifikimit duhet të sigurojë që operatori të jetë në gjendje të veprojë në përputhje me Ligjin e Kosovës për Aviacionin Civil, rregulloret e AAC-së dhe standardet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me operimin e avionëve siç është publikuar në Anekset përkatëse të Konventës mbi Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC).

Procesi i certifikimit të operatorit ajror përbëhet nga pesë faza. Çdo fazë përshkruhet në detaje të mjaftueshme për të siguruar një kuptim të përgjithshëm të gjithë procesit të certifikimit. Pesë fazat janë:

- 1) **Para-aplikimi**
- 2) **Aplikimi Zyrtar**
- 3) **Vlerësimi i Dokumentacionit**
- 4) **Demonstrimi dhe Inspektimi**
- 5) **Certifikimi**

Në disa raste, udhëzimi dhe sekuenca e sugjeruar e ngjarjeve në këtë MU nuk mund të jenë plotësisht i përshtatshëm. Në situata të tilla, AAC-ja dhe operatori duhet të procedojnë në një mënyrë që i merr parasysh kushtet dhe rrethanat ekzistuese. Operatori, megjithatë, nuk duhet të presë që të certifikohet derisa AAC-ja të sigurohet se Ligji nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, rregulloret zbatuese dhe legjislacioni i aplikueshëm i ECAA-së do të respektohen në mënyrë të përshtatshme dhe të vazhdueshme.

Të pesë fazat duhet të shihen si hapa. Për të vazhduar procesin e certifikimit duhet të përfundojë faza paraprake. Prandaj, procesi i certifikimit nuk do të vazhdojë pa u përfunduar të gjitha pikat, nenet dhe detyrat individuale në fazën paraprake të certifikimit.

FAZA 1	FAZA 2	FAZA 3	FAZA 4	FAZA 5
Faza para aplikimit	Faza e aplikimit zyrtar	Faza e vlerësimit të dokumentacionit	Faza e demonstrimit dhe inspektimit	Faza e certifikimit

Ky Material Udhëzues (MU) është shkruar për të dhënë një pasqyrë rreth procesit të certifikimit prej 5 fazash për Certifikatën e Operatorit Ajror (COA) në përgjithësi.

Procesi i certifikimit në 5 faza është një standard i botuar nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ONAC) dhe i njohur nga Administrata Federale e Aviacionit (FAA). Secila fazë duhet të përfundojë para se të fillojë tjetra.

Aplikimi për COA është një punë e gjatë dhe e kushtueshme. Shumë shpesh kjo punë nënvlerësohet. AAC-ja pranon vetëm aplikacionet për COA që janë në përputhje me standardet e Rregullores së AAC-së nr. 01/2019. Të gjithë formularët e aplikacionit duhet të nënshkruhen në mënyrë të rregullt nga njerëzit e kërkuar në origjinal, ndërsa nënshkrimet elektronike nuk pranohen.

Projekti mund të vonohet për shkak të aplikacioneve të tjera që janë në zhvillim e sipër ose për shkak të cilësisë së parashtrësive ose pjesëve që mungojnë. Në rast se ndonjë nga mbajtësit e propozuar të postit nuk arrin notën e duhur në vlerësim, projekti mund të vonohet edhe më shumë derisa të jetë pranuar i gjithë personeli menaxhues.

Nëse aplikuesi ka nevojë për informata të mëtejme, të kontaktojë në adresën më poshtë:

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Lagjja Arbëria, Rruga Ahmet Krasniqi, nr. 208
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

E-mail: infocaa@caa-ks.org

Tel: +383 38 248 629

Fax: +383 38 211 009

Lista e faqeve efektive (LFE)

Kapitulli	Faqe	Rishikimi nr.	Data efektive
Parathënie	2 nga 22	6	17 maj 2019
	3 nga 22	6	17 maj 2019
	4 nga 22	6	17 maj 2019
Lista e faqeve efektive	5 nga 22	6	17 maj 2019
Tabela e përmbajtjes	6 nga 22	6	17 maj 2019
Faza para aplikimit	7 nga 22	6	17 maj 2019
	8 nga 22	6	17 maj 2019
	9 nga 22	6	17 maj 2019
Faza e aplikimit zyrtar	10 nga 22	6	17 maj 2019
Faza e vlerësimit të dokumentacionit	11 nga 22	6	17 maj 2019
Faza e demonstrimit dhe inspektimit	12 nga 22	6	17 maj 2019
Faza e certifikimit	13 nga 22	6	17 maj 2019
Kostot dhe orari	14 nga 22	6	17 maj 2019
Shtojca-1	15 nga 22	6	17 maj 2019
Shtojca-2	16 nga 22	6	17 maj 2019
Shtojca-3	17 nga 22	6	17 maj 2019
Shtojca-4	18 nga 22	6	17 maj 2019
Shtojca-5	19 nga 22	6	17 maj 2019
Shtojca-6	20 nga 22	6	17 maj 2019

Kontrolli i dokumentit

	Emri dhe pozita	Data	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Kushtrim Musa Drejtor, Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve	20 prill 2019	
Kontrolli i cilësisë nga:	Lendita Kika-Berisha Drejtoreshë, Departamenti i Cilësisë dhe Sigurisë	15 maj 2019	
Miratuar nga:	Eset Berisha Drejtor i Përgjithshëm	17 maj 2019	

Përmbajtja

Parathënie	2 nga 22
Qëllimi	2 nga 22
Rregulloret relevante	2 nga 22
Materialet dhe dokumentet relevante	2 nga 22
Sfondi	2 nga 22
Lista e faqeve efektive	5 nga 22
Përmbajtja	6 nga 22
Faza para aplikimit	7 nga 22
Faza e aplikimit zyrtar	10 nga 22
Faza e vlerësimit të dokumentacionit	11 nga 22
Faza e demonstrimit dhe inspektimit	12 nga 22
Faza e certifikimit	13 nga 22
Kostot dhe afatet kohore	14 nga 22
Shtojcat	15 nga 22
Shtojca 1 – Lista kontrolluese për fazën para aplikimit	15 nga 22
Shtojca 2 – Lista kontrolluese për fazën e aplikimit zyrtar	16 nga 22
Shtojca 3 – Rregulloret, dokumentet, adresat e ueb-faqeve	17 nga 22
Shtojca 4 – Vegëza të dobishme	18 nga 22
Shtojca 5 – Shkurtesat	19 nga 22
Shtojca 6 – Diagramet (5 fazat e procesit të certifikimit nga AACK-ja)	20 nga 22

1. Faza para aplikimit

Operatori informohet nga AAC-ja për të marrë informatat e nevojshme përmes faqes zyrtare të internetit (<https://caa.rks-gov.net>) në mënyrë që të ndjekë materialin udhëzues në dispozicion. Nëse operatori i ardhshëm synon të vazhdojë me certifikimin, Formularët CAAK/FSD/AOC-1 dhe CAAK/FSD/EASA-4 lidhur me funksionet e synuara të menaxhimit (p.sh. personat e nominuar) i dërgohen me postë aplikantit ose aplikanti i shkarkon nga faqja zyrtare e AAC-së.

Formularët CAAK/FSD/AOC-1 dhe CAAK/FSD/EASA-4 duhet të plotësohen, nënshkruhen nga operatori i ardhshëm dhe t'i kthehen AAC-së. Përveç kësaj, operatori do të dorëzojë planin e biznesit, dokumentet për vërtetimin e gjendjes financiare dhe rrjedhën e mjaftueshme të parasë, planin e infrastrukturës së synuar, një prezantim të rrjetit dhe një deklaratë me shkrim për përmbushjen e çështjeve ligjore të kërkuara.

Rregullorja e AAC-së nr. 01/2019 (ORO.GEN.130, ORO.GEN.135 dhe ORO.GEN.135 (a)) përcaktojnë pozitat themelore të menaxhimit dhe kualifikimet minimale për operatorët ajrorë që propozojnë kryerjen e operacioneve komerciale të transportit ajror. Individët e caktuar në pozitat e kërkuara të menaxhimit duhet të kenë një njohuri të plotë të dispozitave operative të rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare. Formulari CAAK/FSD/AOC-1 duhet të përmbajë rezymetë e kualifikimeve, licencave (duke përfshirë numrat e licencave), vlerësimeve dhe përvojës/arsimimit të aviacionit për secilën nga pozicionet e mëposhtme ose ekuivalentin e tyre:

- Menaxheri Përgjegjës (MP)
- Menaxheri për Monitorimin e Pajtueshmërisë (MMP)
- Menaxheri për Monitorimin e Sigurisë (MMS)
- Personi i Nominuar për Operacionet e Fluturimit (PN OF)
- Personi i Nominuar për Operacionet Tokësore (PN OT)
- Personi i Nominuar për Trajnimin e Ekuipazhit (PN TE)
- Bartësi i Postit për Vlefshmërinë e Vazhdueshme Ajrore (BVA)
- Zëvendës Menaxheri Përgjegjës (ZMP)
- Zëvendës Menaxheri për Monitorimin e Pajtueshmërisë (ZMMP)
- Zëvendës Personi i Nominuar për Operacionet e Fluturimit ((ZPOF)
- Zëvendës Personi i Nominuar për Operacionet Tokësore (ZPOT)
- Zëvendës Personi i Nominuar për Trajnimin e Ekuipazhit (ZPTE)
- Zëvendës Bartësi i Postit për Vlefshmërinë e Vazhdueshme Ajrore (ZBVA)

Personeli i AAC-së do të shqyrtojë Formularët CAAK/FSD/AOC-1, CAAK/FSD/EASA-4 dhe të gjitha dokumentet e tjera të dorëzuara. Nëse informatat nuk janë të plota ose janë me gabime, formularët do t'i kthehen operatorit të ardhshëm bashkë me arsyet për kthimin e tij. Dështimi për të ofruar ndonjë dokumentacion mbështetës brenda afateve të arsyeshme mund të rezultojë në pezullimin e aplikimit të aplikuesit. AAC-ja do të anulojë çdo aplikacion që mbetet i pezulluar/pa përgjigje për më shumë se 45 ditë.

Nëse informatat janë të plota dhe të pranueshme, AAC-ja do të ftojë kandidatët për person të nominuar dhe zëvendësit e tyre në seancën e ardhshme të vlerësimit në dispozicion, ku kandidatët do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit.

MIT-ja do të vlerësojë sfondin financiar të operatorit dhe aspektin e tij ligjor, do të vlerësojë planin e biznesit të operatorit dhe do të vlerësojë disponueshmërinë e infrastrukturës dhe logjistikës së nevojshme.

SHËNIM: Vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha parakushtet e mësipërme dhe të pranohen, do të lejohet vazhdimi i këtij procesi.

Qëllimi i takimit para aplikimit është që të konfirmohen informatat në formularin CAAK/FSD/AOC-1 dhe të sigurojë informacionin kritike të certifikimit për aplikuesin. Është e domosdoshme që Menaxheri i Përgjegjshëm i Operatorit (ACM) dhe personat e emëruar dhe nënkryetarët e emëruar të marrin pjesë në mbledhjen e para-aplikimit dhe të jenë të përgatitur për të diskutuar në terma të përgjithshëm, plane dhe aspekte specifike të operacionit të propozuar. Shumë probleme mund të shmangen duke diskutuar të gjitha aspektet e operacionit të propozuar dhe kërkesat specifike, të cilat duhet të plotësohen për t'u certifikuar si një operator ajror.

Është e rëndësishme të krijohen marrëdhënie të mira pune dhe kuptime të qarta ndërmjet AAC-së dhe përfaqësuesve të operatorit. AAC-ja njih se ekziston një gamë e gjerë aftësish dhe ekspertize midis operatorëve. Kjo përvojë e sfondit do të merret parasysh nga AAC-ja dhe do të përshtatet gjatë këtyre takimeve fillestare.

SHËNIM: Për të ndihmuar në promovimin e të kuptuarit gjatë procesit të certifikimit, do të ofrohet një paketë informacioni për aplikim kur kërkohet ose më së fundi në mbledhjen para aplikimit.

Rregullorja e AAC-së nr. 01/2019 përcakton që aplikacioni për një COA duhet të bëhet në një formë dhe mënyrë të pranueshme për Autoritetin dhe të përmbajë çdo informacion që Autoriteti kërkon që aplikanti të paraqesë. Është e rëndësishme të kuptohet dokumentacioni minimal i nevojshëm për t'u konsideruar i pranueshëm për një aplikim formal. Aplikimi formal duhet të bëhet në një formular të siguruar nga Autoriteti (AAC/FSD/AOC-1) dhe me një letër ku kërkohet certifikimi si operator ajror. Menaxheri i Përgjegjshëm duhet të nënshkruajë formularin dhe letrën. Letra e dorëzuar duhet të përfshijë një deklaratë që letra shërben si aplikim formal për një Certifikatë të Operatorit Ajror.

Plani i ngjarjeve/Plani i implementimit: Orari i ngjarjeve është një dokument kyç që liston artikujt, aktivitetet, programet dhe blerjet e avionëve dhe/ose objekteve që duhet të kryhen ose të bëhen gati për inspektimin e AAC-së përpara certifikimit. Ai duhet të përfshijë datat kur anëtarët e ekuipazhit do të fillojnë procedurat e indoktrinimit të kompanisë dhe/ose trajnimit.

Gjithashtu, orari i ngjarjeve duhet të përfshijë datat kur do të fillojë trajnimi i personelit të mirëmbajtjes, kur objektet e mirëmbajtjes do të jenë gati për inspektimin e AAC-së, kur secili prej manualeve të kërkuar do të jetë në dispozicion për vlerësim, kur aeroplani do të jetë gati për inspektim, objektet do të jenë gati për inspektim dhe fluturimet e demonstrimit janë planifikuar të kryhen. Këto data të vlerësuara duhet të jenë logjike në kuptim të rendit. Për shembull, data e parashikuar për trajnimin themelor të kompanisë së ekuipazhit për trajnimin e terrenit të indoktrinimit duhet të jetë pas datës që pjesët e manualeve të kompanisë që lidhen me performancën e personelit të ekuipazhit do të plotësohen dhe dorëzohen. Plani i përkohshëm tregon qëllimin e operatorit për menaxhimin e kohës. Megjithatë, një skemë e caktuar e zbatimit e cila do të zëvendësojë orarin e përkohshëm do të përshtatet dhe do të pajtohet më vonë gjatë fazës së aplikimit formal në lidhje me menaxhimin e kohës reale dhe

burimet njerëzore në dispozicion. Plani i caktuar i zbatimit është subjekt i pranimit nga Menaxheri i Projektit (MP) i AAC-së dhe është atëherë dokumenti i dakorduar gjatë gjithë procesit të certifikimit.

Sistemi i Manualeve të Operimeve: Këto manuale, të cilat duhet të lëshohen në pjesë të veçanta për përdoruesit e caktuar, përmbajnë politika, udhëzime, informacione, detyra dhe përgjegjësi për operimin e sigurt dhe aeroplanët ajrorë. I gjithë sistemi i manualëve duhet të zhvillohen tërësisht në kohën e aplikimit formal.

Është e njohur se blerja e avionëve, aranzhimet e objekteve dhe nënkontraktuesit dhe disa elemente të programeve të trajnimit dhe kontrollit nuk mund të zhvillohen plotësisht në kohën e aplikimit zyrtar.

Sidoqoftë, Manuali i Operimeve Pjesa D - Trajnimi, i krijuar në përputhje me Konceptin e Vendosur të Trajnimit, duhet të përfundojë në maksimumin e mundshëm. Formimi fillestar i kompanisë dhe pjesa e kurrikulës së kontrollit të OM-D duhet t'i bashkëngjitet letrës zyrtare të aplikimit.

Dokumentet e Blerjes, Qirasë, Kontratave dhe/ose Letrave të Qëllimit: Këto bashkëngjitje duhet të sigurojnë dëshmi se operatori është në proces të sigurimit aktiv të avionëve, objekteve dhe shërbimeve të përshtatshme për llojin e operacionit të propozuar. Nëse kontratat zyrtare nuk janë plotësuar, letra ose dokumente të tjera që tregojnë marrëveshje paraprake ose synime do të mjaftojnë deri në atë datë të përcaktuar nga AAC-ja.

- Avionët,
- Objektet dhe shërbimet e stacionit,
- Objektet dhe shërbimet për mbledhjen e informatave të motit,
- Pajisjet dhe shërbimet e komunikimit,
- Objektet dhe shërbimet e mirëmbajtjes,
- Marrëveshjet kontraktuale të mirëmbajtjes,
- Listat aeronautike dhe botimet përkatëse,
- Analiza e aerodromit dhe të dhënat e pengesave,
- Tabelat e performancës së ngritjes dhe uljes së avionëve në lidhje me pista individuale,
- Trajnimi i kontraktuar dhe objektet e trajnimit.

Lista e përputhshmërisë: Kjo listë përmban të gjitha nenet dhe paragrafët e zbatueshëm të Rregullores së AAC-së nr. 01/2019, ku operatori deklaron se ai është në përputhje me kërkesat përkatëse. Përveç kësaj, lista tregon kapitujt dhe/ose nën-kapitujt brenda Sistemit të Manualit të Operimeve, ku përshkruhet përshtatshmëria e duhur. Lista e plotësuar plotësisht e përputhjes siguron që çdo kërkesë e zbatueshme rregullative është adresuar në mënyrë adekuate në manualet, programet dhe/ose procedurat përkatëse. Për më tepër, në listën e përputhshmërisë të MO, aty ku është e aplikueshme, përfshihen pranimet formale dhe miratimet.

Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së emëron një Menaxher Projekti (MP), i cili do të udhëheqë projektin e përmendur dhe do të udhëheqë operatorin përmes gjithë procesit të certifikimit.

2. Faza e aplikimit zyrtar

Aplikacioni zyrtar duhet të dorëzohet në AAC sa më parë që të jetë e mundur.

AAC-ja do të shqyrtojë aplikacionin për të parë nëse ai përmban informatat, dokumentet dhe bashkëngjitjet e kërkuara. Nëse ka lëshime ose gabime, aplikacioni zyrtar dhe të gjitha bashkëngjitjet do të kthehen bashkë me një letër që përshkruan arsyet për kthimin e tij. Nëse operatori i kupton mirë kërkesat, aplikacioni zyrtar duhet të jetë i cilësisë së mjaftueshme për të lejuar që çdo lëshim, mungesë ose pyetje e hapur të zgjidhet gjatë takimit të aplikimit zyrtar.

Në takimin e aplikimit zyrtar duhet të marrin pjesë Menaxheri Përgjegjës i Operatorit, Menaxheri i Monitorimit të Pajtueshmërisë, Zyrtari i Nominuar dhe Zëvendësi i tij. Qëllimi i takimit është që të prezantohet menaxheri i projektit, inspektorët e deleguar, ekspertët dhe specialistët, si dhe të diskutohet aplikacioni zyrtar dhe të zgjidhen lëshimet, mangësitë ose t'u jepet përgjigje pyetjeve nga secila palë. Për shembull, ky takim mund të përdoret për të zgjidhur çështjet që kanë të bëjnë me paketën e aplikantit ose mospërputhjet e datës së caktimit, ose për të siguruar që aplikanti e kupton procesin e certifikimit. Ky takim duhet gjithashtu të përdoret për të përforcuar komunikimin e hapur dhe marrëdhëniet e punës.

Nëse takimi i aplikimit zyrtar është i suksesshëm, operatorit i jepet një letër që konfirmon pranimin dhe pranueshmërinë e paketës nga Drejtori i Përgjithshëm ose Menaxheri i Projektit (MP). Pranimi i aplikacionit zyrtar nga AAC-ja nuk nënkupton miratimin ose pranimin e bashkëngjitjeve individuale.

3. Faza e vlerësimit të dokumentacionit

Pas pranimit të aplikacionit zyrtar, inspektorët e AAC-së do të fillojnë një vlerësim të hollësishëm të të gjithë doracakëve, formularëve dhe dokumenteve të dorëzuara. Inspektimi i Sistemit të Manualit të Operimeve, në varësi të madhësisë së operimit, mund të bëhet në të gjithë manualin ose në pjesë të ndryshme në kohë të ndryshme me ekspertë të ndryshëm. AAC-ja do të përpiqet të përfundojë këto vlerësime në përputhje me planin e dakorduar të ngjarjeve. Nëse një manual ose dokument është jo i plotë ose i mangët ose nëse zbulohet mosrespektimi i rregullave ose praktikave të përdorimit të sigurt, manuali ose dokumenti do të kthehen për veprime korrigjuese. Nëse manualet dhe dokumentet janë të kënaqshme, përmbajtja dhe struktura do të pranohen, siç kërkohet. Pranimi dhe miratimi zyrtar do të jepen në dokumentacion specifik dhe do të hyjnë në fuqi vetëm pasi operatori të ketë marrë dokumentacionin përkatës, të nënshkruar nga AAC-ja dhe në përputhje me datën e hyrjes në fuqi. Megjithatë, përgjegjësia për të gjitha përmbajtjet e dokumentuara dhe të botuara të çdo manuali ose dokumenti të kompanisë i takon menaxherit përgjegjës të nominuar dhe personave të nominuar të pranuar dhe zëvendësve të tyre.

Faza e Vlerësimit të Dokumentacioni plotësohet me pranimin zyrtar të përmbajtjes dhe strukturës së Sistemit të Manualit të Operimeve, të lëshuar për dokumente të ndryshme. Deklarata fillestare e pajtueshmërisë së dokumenteve është parakusht për të vazhduar Fazën e Inspektimit dhe Demonstrimit.

4. Faza e demonstrimit dhe inspektimit

Para kryerjes së Fazës së Demonstrimit dhe Inspektimit, pritët që aplikanti për COA të ketë zbatuar të gjitha procedurat dhe praktikët e veprimit siç përshkruhet në Sistemin e Manualit të Operimeve dhe që Sistemi i Cilësisë të ketë rishikuar me sukses të gjitha fushat e operimit duke përfshirë subjektet e kualifikuara me anë të auditimeve dhe inspektimeve. Rregulloret kombëtare dhe standardet e ICAO-së kërkojnë nga një operator që të demonstrojë aftësinë e tij për të qenë në pajtueshmëri me rregulloret dhe praktikët e sigurta operative para fillimit të operacioneve fitimprurëse. Këto demonstrime përfshijnë performancën aktuale të aktiviteteve dhe/ose operacioneve ndërkohë që vëzhgohen nga inspektorët e AAC-së. Kjo përfshin vlerësimet në terren të pajisjeve të mirëmbajtjes së avionëve dhe objekteve mbështetëse. Gjatë këtyre demonstrimeve dhe inspektimeve, AAC-ja vlerëson efektivitetin e politikave, metodave, procedurave dhe udhëzimeve siç përshkruhet në manualët e operatorit dhe në dokumente të tjera. Theksi vihet në efektivitetin e menaxhimit të operatorit gjatë kësaj faze. Mangësitë do të sillen në vëmendjen e operatorit dhe duhet të ndërmerren veprime korrigjuese para se të hyhet në fazën e certifikimit.

Megjithëse faza e vlerësimit të dokumentacionit dhe ajo e demonstrimit dhe inspektimit janë diskutuar veçmas në këtë MU, këto faza mund të mbivendosen në aspektin e trajnimit ose mund të realizohen njëkohësisht në praktikën aktuale. Lista e mëposhtme jep shembuj të llojit të artikujve që vlerësohen gjatë fazës së demonstrimit dhe inspektimit.

- Sistemi i Monitorimit të Pajtueshmërisë
- Pajisjet dhe Infrastruktura
- Trajnimi dhe kontrolli (klasa, simuluesit, avioni, fluturimi dhe trajnimi i personelit tokësor).
- Kontrolli dhe mbikëqyrja operacionale
- Shtigjet e fluturimeve
- Procedurat e komunikimit të kompanisë
- Objektet e stacionit (pajisjet, procedurat, personeli, mbushja/zbraza e karburantit, heqja e borës, të dhënat teknike).
- Kontrollimi i dokumenteve (kontrolli, analiza dhe ruajtja e regjistrave, dokumenteve të fluturimit, si dhe informatave dhe të dhënave shtesë).
- Manuali i Procedurës së Kontratës (MPK)
- Programi i mirëmbajtjes/Kontrata e mirëmbajtjes
- CAME – Ekspozimi i Mirëmbajtjes së Vazhdueshme të Vlefshmërisë Ajrore
- Efikasiteti i reagimit emergjent

Fluturimet e plota demonstruese. Kjo përfshin simulimin në shkallë të plotë të operimeve fitimprurëse për të demonstruar aftësinë për të vepruar në mënyrë të pavarur, të sigurt dhe në përputhje me Rregulloren e AAC-së nr. 01/2019, duke përfshirë devijimet nga ruta dhe/ose uljen në pistë për situata jonormale dhe emergjente.

SHËNIM: *Një aplikues për Certifikatën e Operatorit Ajror (COA) mund të kërkojë njëkohësisht aprovimin e AAC-së për organizatën e tij të mirëmbajtjes (AES A Pjesa 145). Aplikuesi duhet të bashkërendojë ecurinë e të dy projekteve të certifikimit. Të dy projektet e certifikimit duhet të jenë në fazën e Demonstrimit dhe Inspektimit në të njëjtën kohë. Kjo është për shkak se fluturimet e demonstrimit kërkojnë që aplikuesi t'i demonstrojë AAC-së të gjitha operacionet e propozuara ajrore dhe tokësore.*

5. Faza e certifikimit

Kur veprimet korrigjuese nga të gjeturat e dala nga Faza e Demonstrimit dhe Inspektimit përfundohen dhe mbyllen, AAC-ja do të lëshojë deklaratën përfundimtare të pajtueshmërisë dhe do të përgatisë miratimin e Nën-pjesës G dhe Certifikatën e Operatorit Ajror (COA). Operacionet pastaj specifikohen, renditen dhe miratohen brenda dokumentit të specifikimeve të operacioneve (AOC OPS SPECS). Drejtori i Përgjithshëm i AACK-së nënshkruan miratimin e Nën-pjesës G dhe AOC-në. Pas kësaj, MIT lëshon licencën e operimit me kufizimet e saj për aplikantin.

Bartësi i certifikatës është përgjegjës për pajtueshmërinë e vazhdueshme me rregulloret sipas autorizimeve, kufizimeve dhe specifikimeve të tij. Procesi për ndryshimin e specifikimeve është i ngjashëm me procesin e certifikimit. AAC-ja është përgjegjëse për kryerjen e inspektimeve dhe auditimeve periodike të veprimtarisë së bartësit të certifikatës për të siguruar pajtueshmërinë e vazhdueshme me rregulloret, praktikat e sigurta operationale dhe vlefshmërinë ajrore. Megjithatë, pajtueshmëria me të gjitha ligjet dhe rregulloret mbetet gjatë gjithë kohës përgjegjësi e operatorit.

6. Kostot dhe afatet kohore

Procesi i plotë certifikimi i merr kohë si aplikantit, ashtu edhe autoritetit. Kostot dhe afatet kohore ndryshojnë shumë varësisht nga cilësia e manualeve të dorëzuar dhe burimeve në dispozicion të AAC-së. Sipas Rregullores nr. 2/2015 të ndryshuar me Rregulloren nr. 5/2018 për Tarifat e Ngarkuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, neni 9 paragrafi 9.1 përcakton që AAC-ja do të ngarkojë tarifa për inspektimin dhe mbikëqyrje të organizatës së operatorit ajror për qëllim të dhënies, ndryshimit ose rinovimit të Certifikatës së Operatorit Ajror, në shumë prej 4,000 € për aeroplanin e parë dhe 2,000 € shtesë për çdo aeroplan tjetër me PMN (MTOW) prej më shumë se 40,000 kg. Kosto shtesë prej 700 € do të ngarkohet për lëshimin e certifikatës së vlefshmërisë ajrore për aeroplan, të përfshirë në kategorinë e transportit komercial. AAC do të ngarkojë gjithashtu një tarifë për çdo kërkesë për lëshimin e certifikatës së regjistrimit të një aeroplani me më shumë se 5,700 kg MTOW një shumë prej 500 €.

Një vlerësim i parë për afatet kohore mund të jetë i mundur pas shqyrtimit të përciptë në fillim të fazës së aplikimit formal. Në këtë pikë mund të jetë e mundur një vlerësim i parë në lidhje me afatet kohore dhe kostot. Zbatimi i afateve kohore do të jetë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

AAC-ja kërkon që 50% e tarifës në lidhje me shërbimet e përmendura në nenet përkatëse të Rregullores nr. 2/2015, të ndryshuar me Rregulloren nr. 5/2018, t'i paguhen AAC-së para se të fillojë kryerja e shërbimeve, ndërsa pjesa tjetër prej 50% para lëshimit ose rinovimit përfundimtar të certifikatës, licencës, miratimit ose autorizimit.

Shtojcat

Shtojca 1 – Lista kontrolluese për fazën para aplikimit

Lista kontrolluese, gfarë duhet bërë në fazën para aplikimit ose në fillim të Fazës së Aplikimit Zyrtar

- Formulari AACK/DSF/AOC-1 (aplikacioni për AOC & AESA Pjesa M, nën-pjesa G miratimi (CAMO));
- Kontratat e qirasë ose letra e synimit për të gjithë avionët;
- Dëshmi të pjesëtarëve të ekuipazhit;
- Marrëveshja e qirasë për hapësirat për zyrë për personin e nominuar për operacionet e fluturimit;
- Plani i biznesit për mbi 2 vjet;
- Plani i biznesit për 3 muajt e parë të operimit pa të ardhura;
- Certifikata për sigurimin e përgjegjësisë ligjore për udhëtarë dhe përgjegjësia ligjore e palës së tretë;
- Aplikacioni për lirim sipas nenit 40.2 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (Plotësimi i kushteve për regjistrimin e avionëve), nëse vlen;
- Kopja e noterizuar e Certifikatës së Regjistrimit të biznesit në Republikën e Kosovës dhe shtojcave të saj;
- Statuti (duke përfshirë qëllimin e operimit ajror komercial të kompanisë);
- Bilanci hapës;
- Kopja nga libri i aksionarëve (lista e aksionarëve);
- Formulari AACK/DSF/EASA- 4
- Specifikacioni Operativ i Vlefshmërisë Ajrore aplikimi për aeroplan kompleksë

Shtojca 2 – Lista kontrolluese për fazën e aplikimit zyrtar

- Formulari i Rishikimit/Ndryshimit të Propozuar (RNP) për secilin manual
- OM-A
- Manuali i Monitorimit të Organizatës (OMM)
- OM-B për secilin tip aeroplani (sipas faqes së parë të vlerësimit të dokumenteve OM-B)
- OM-C
- OM-D
- Lista e Pajtueshmërisë (LP)
- CSPM – Manuali i Procedurës së Sigurisë së Kabinë (duke përfshirë Kartën e Sigurisë në Kabinë), nëse vlen
- LPM – Lista e Pajisjeve Minimale
- OPS Nën-pjesët K & L
- EASA 26
- Programi i Sigurisë
- Mallrat e Rrezikshëm
- CAME – Ekspozimi i Menaxhimit të Vazhdueshëm të Vlefshmërisë Ajrore
- Kontrata e Mirëmbajtjes
- Manuali i Procedurës së Mirëmbajtjes
- Ditari Teknik i Aeroplanit (Ditari Teknik)
- Programi i Mirëmbajtjes
- Programi i besueshmërisë
- Aplikacioni për PBN (RNAV duke përfshirë RNP, etj.)
- Aplikacioni për ETOPS, nëse vlen
- Aplikacioni për RVSM, nëse vlen
- Aplikacioni për MNPS, nëse vlen
- Aplikacioni për AWO duke përfshirë LVTO, nëse vlen
- Aplikacioni për Afrimet e Pjerrëta, nëse vlen
- Aplikacioni për Çantën Elektronike të Fluturimit (EFB)
- Aplikacioni për FANS (p.sh. CPDLC, ADS-B, kreditë operative si HUD, etj.)
- Orari i implementimit të specifikacioneve operative
- Manuali i trajtimit tokësor, nëse vlen
- Aplikacioni për CMC (Certifikata e Pjesëtarit të Ekuipazhit)
- Aplikacioni për kodin dhe shenjën e thirrjes të ICAO-së
- Aplikacioni për licenca të itinerarit, nëse vlen
- Plani i orarit, nëse vlen
- Plani i biletave ajrore, nëse vlen
- Lista e aeroplanëve, tipi i avionit, regjistrimi, numri serik, baza amë, kapaciteti i ulëseve të udhëtarëve

Shtojca 3 – Rregulloret dhe dokumentet

- Ligji nr. 03/L-051** për Aviacionin Civil;
Rregullorja 2010/1 për Rregullat e Përbashkëta për operimin e shërbimeve ajrore (MIT);
Rregullorja 01/2016 për plotësimin e standardeve të përgjithshme themelore për sigurinë a aviacionit civil (MPB);
Rregullorja 01/2019 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative lidhur me operimet ajrore (AAC);

EASA STD
EASA NPA's
EN
EASA-21
EASA-23
EASA-25
EASA-26
EASA-145

- ICAO Shtojca 1** Licencimi i personelit
ICAO Shtojca 2 Rregullat në ajër
ICAO Shtojca 6 Operimi i avionëve
ICAO Shtojca 8 Vlefshmëria ajrore e avionëve
ICAO Shtojca 11 Shërbimet e trafikut ajror
ICAO Shtojca 10 Telekomunikimi
ICAO Shtojca 12 Kërkim-shpëtimi

Dokumente të tjera të ONAC-it

- Qarkorja 253-AN/151** Doracak mbi faktorët njerëzor nr. 12 Faktorët Njerëzorë në Mirëmbajtjen dhe Inspektimin e Avionëve
Dokumenti 4444-RAC/501 Rregullat Ajrore dhe Shërbimi i Trafikut Ajror
Dokumenti 7030 Plotësimi Rajonal
Dokumenti 8168-OPS Operacionet me Avionë
Dokumenti 8335-AN/879 Manuali i Procedurave për Inspektimin, Certifikimin dhe Mbikëqyrjen e Vazhdueshme të Operacioneve
Dokumenti 9284-AN/905 Udhëzimet Teknike për Transportin e Sigurt të Mallrave të Rrezikshme përmes Ajrit
Dokumenti 9365-AN/910 Operacionet në çdo mot
Dokumenti 9376-AN/914 Përgatitja e Manualit të Operacioneve
Dokumenti 9379-AN/916 Manuali dhe Procedurat për Themelimin dhe Menaxhimin e Sistemit Shtetëror për Licencimin e Personelit
Dokumenti 9389-AN/919 Manuali i Procedurave për një Organizatë të Vlefshmërisë Ajrore
Dokumenti 9642-AN/941 Manuali i Vlefshmërisë Ajrore të Vazhdueshme

Shtojca 4 – Vegëza të dobishme

MIT	http://mit-ks.net/
MPB	https://mpb.rks-gov.net/
AEA	http://www.aea-europe.net/
ATA	http://www.air-transport.org/
EASA	http://www.easa.eu.int/home/index.html
ECAC	http://www.ecac-ceac.org/index.php
EUROCONTROL	https://www.eurocontrol.int/
EUR-LEX	http://eur-lex.europa.eu/de/index.htm
FSF	http://www.flightsafety.org/home.html
IATA	http://www.iata.org/index.asp
ICAO	http://www.icao.int/

Shtojca 5 – Shkurtesat

Shkurtesat në vijim janë përdorur në këtë Material Udhëzues Administrativ:

Shkurtesa	Përkufizimi
AEA	Asociacioni Evropian i Kompanive Ajrore
AGL	Broshura me Udhëzime Administrative
AMC	Mjetet e Pranueshme e Përputhshmërisë
AOC	Certifikata e Operatorit Ajror
ATA	Shoqata e Transportit Ajror
CAAK	Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
EASA	Agjencia Evropiane për Siguri të Aviacionit
ECAC	Konferenca Evropiane e Aviacionit Civil
FAA	Administrata Federale e Aviacionit
FSF	Fondacioni i Sigurisë së Fluturimit
GM	Material Udhëzues
IATA	Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror
ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
LoR	Ditari i Rishikimeve
NAA	Autoriteti Kombëtar i Aviacionit
NPA	Njoftime për Ndryshimet e Propozuara
OD	Direktivat Operative
PM	Menaxher i Projektit


Shtojca 6 – Diagramet (Procesi i certifikimit me 5 faza e AAC-së)



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



CAA Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo



The 5 Phases of Certification Process

Civil Aviation Authority of Kosovo

April 2019

